

2012



100 Vjet Pavarësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave

Raporti fiskal mujor

Janar - Tetor, 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

TREGUESIT FISKALË PËR PERIUdhËN JANAR – TETOR 2012	2
ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR – TETOR 2012	2
Vështrim i përgjithshëm	2
Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera.....	4
Taksimi i konsumit (indirekt)	4
Taksimi direkt.....	7
ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – TETOR 2012	11
Vështrim i përgjithshëm	11
Shpenzimet Korrente	12
Shpenzimet e Personelit.....	12
Shpenzimet për Interesa	13
Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes	13
Shpenzimet për Subvensione	14
Shpenzimet për Fonde Speciale.....	14
Shpenzime të Pushtetit Lokal	15
Pagesa e Papunësisë	16
Shpenzimet Kapitale.....	16

TREGUESIT FISKALË PËR PERIUdhËN JANAR – TETOR 2012

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 10 mujore arritën në 273.2 miliardë lekë, 6.4 përqind më pak se parashikimi për 10 mujorin e vitit 2012 dhe 2 përqind më shumë se një vit më parë. Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit tetor 2012, arritën në rreth 299.0 miliardë lekë, nga rreth 308.5 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 96.9 përqind të parashikimit të periudhës ose me një mosrealizim prej rreth 9.6 miliardë lekë.

Defiçiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë 10 mujor në -25.7 miliardë lekë, 9.1 miliardë lekë më shumë se planifikimi, dhe 6 miliarde më i ulët se e njëjta periudhë e një viti më parë. Defiçiti është financiar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 853 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e defiçitit; 11.7 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brëndshme neto. Financimi i huaj neto i defiçitit ka qënë në nivelin rreth 13.1 miliardë lekë, ose 703 milionë më pak se planifikimi.

Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për periudhën Janar-Tetor

Milionë lekë	Janar - Tetor '11	Planifikimi Janar - Tetor '12	Janar - Tetor '12
TË ARDHURAT TOTALE	239,518	261,027	244,916
SHPENZIMET TOTALE <i>nga te cilat:</i>	271,148	275,819	270,613
SHPENZIMET KORRENTE	223,885	227,762	228,435
SHPENZIMET KAPITALE	47,263	44,247	40,178
BALANCA FISKALE	-31,630	-14,792	-25,697
BALANCA PRIMARE	-2,787	17,169	3,330

ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR – TETOR 2012**VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM**

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 10 mujore arritën në 273.2 miliardë lekë, 6.4 përqind më pak se parashikimi për 10 mujorin e vitit 2012 dhe 2 përqind më shumë se një vit më parë.

Totali i të ardhurave për 10 mujorin dhe rritja vjetore

EMËRTIMI	10M-2007	10M-2008	10M-2009	10M-2010	10M-2011	10M-2012
TOTALI TE ARDHURAVE (mln lekë)	204,924	235,074	245,269	263,879	267,789	273,244
Rritja vjetore	12.5	14.7	4.3	7.6	1.5	2.0

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat ishin në nivelin 193.1 miliardë lekë, ose rreth 12 miliardë lekë me pak nga afërsisht 205.1 miliardë lekë të planifikuara për periudhën, dhe 2 përqind më shumë se 10 mujori i një viti më parë; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 9.6 miliardë lekë nga 12.6 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë (23.8% më pak) dhe me rënie vjetore prej -5.1 përqind; të ardhurat në fondet speciale arritën 48.3 miliardë lekë nga rreth 49.5 miliardë lekë të planifikuara, me rritje vjetore 2.6 përqind; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 2.7 miliardë lekë nga rreth 2.3 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë 19.6 miliardë lekë nga 18.9 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 3.6 përqind dhe realizim të planit prej 114.4 përqind.

Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 104.8 miliardë lekë, 5.2 përqind më pak se parashikimi për 2012, dhe me rritje 2.9 përqind kundrejt 10 mujorit të vitit 2011. Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, bie në sy performanca e rentës minerare në eksport, që është rritur mbi baza vjetore me rreth 66.7 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore. Të ardhurat nga akciza në doganë rezultojnë me rënie prej 11.6 përqind kundrejt planit dhe -1.2 përqind me pak në krahasim me një vit më parë. Të ardhurat nga TVSH në import janë 2.5 përqind më të larta se një vit më parë dhe -4.8 përqind më pak se parashikimi për periudhën 10 mujore.

Të ardhurat në Dogana sipas muajve dhe krahasimi me 2011

Dogana total 10mujori I 2012	Muaji (milionë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2011
Janar	7,700	-47.1	-4.7
Shkurt	8,779	14.0	8.4
Mars	10,861	23.7	13.1
Prill	9,446	-13.0	0.8
Maj	10,408	10.2	5.0
Qershor	10,945	5.2	-1.6
Korrik	11,282	3.1	2.8
Gusht	12,302	9.0	-7.6
Shtator	10,752	-12.6	5.6
Tetor	12,332	14.7	10
Total	104,806		2.9

Administrata tatimore ka mbledhur (përfshire kontributet) 132.9 miliardë lekë, që do të thotë 1.7 përqind më shumë të ardhura se 10 mujori i vitit 2011 ose 2,157 milion lekë më shumë (përfshirë dhe kontributet). Totali i të ardhurave tatimore (pa përfshire kontributet) ishte për periudhën rreth 88.3 miliardë lekë, duke patur një rritje të lehtë prej 1 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe një mosrealizim të planit në masën -6.6 përqind, ndërsa të ardhurat nga kontributet janë rritur me 3.3 përqind mbi baza vjetore. Administrata tatimore ka rezultate të mira në mbledhjen e taksave nacionale për këtë periudhë krahasuar me një vit më parë me rritje të tyre në masën 40.7 përqind, ndërsa TVSH ka pasur një rënie prej -1.1 % mbi baza vjetore; Tatim Fitimi ka pësuar rënie prej -16.1 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë; Tatimi mbi të ardhurat personale ka pësuar gjithashtu rënie prej -0.6% në krahasim me vitin 2011; Akciza ka pësuar rënie prej -12.9 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti

më parë por duhet marre ne konsiderate ndryshimet e fundit ligjore ku akciza qe me 1 tetor mblidhet nga administrata doganore.

Të ardhurat në Tatime sipas muajve dhe krahasimi me 2011

TATIME total 8mujori i 2012	Muaji (milionë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2011
Janar	14,071	-3.3	1.1
Shkurt	12,016	-14.6	2.6
Mars	14,128	17.6	-2.1
Prill	13,252	-6.2	4.8
Maj	12,567	-5.2	-3.8
Qershor	12,882	2.5	7.9
Korrik	14,392	11.7	4.9
Gusht	14,045	-2.4	14.7
Shtator	13,051	-7	1.6
Tetor	12,429	-4.77	-12.1
Total	107,412		1.7

Nga totali i te ardhurave Tatimore sipas Sektoreve Ekonomikë ne krahasim me 10 mujorin e vitit 2011 shikojmë rënie në sektoret e Prodhimit me -25.7% dhe ndertimit me -12.5%. Sektorët që kanë pësuar rritje janë Transporti, Tregtia dhe Shërbimet përkatësisht 2.8%, 10.2% dhe 7.1%.

Të ardhurat tatimore sipas sektoreve kryesorë të ekonomisë

Emërtimi	10mujor 2011	10mujor 2012	Ndryshimi	Subjekte pagues 2011	Subjekte pagues 2012	Ndryshimi
	<i>(mln leke)</i>	<i>(mln leke)</i>	<i>ne %</i>	<i>numër</i>	<i>numër</i>	<i>ne %</i>
Prodhim	19,559	14,540	-25.7%	9,708	9,758	0.5%
Ndërtim	7,744	6,773	-12.5%	6,448	6,503	0.9%
Transport	4,929	5,067	2.8%	2,205	2,341	6.1%
Tregti	22,769	25,093	10.2%	19,764	20,651	4.5%
Shërbime	33,825	36,244	7.1%	26,595	28,220	6.1%
Të tjera të paspecifikuara	67	142	112.5%	308	706	129.2%

TË ARDHURAT SIPAS TAKSAVE, TATIMEVE DHE BURIMEVE TË TJERA

TAKSIMI I KONSUMIT (INDIREKT)

Nga TVSH janë mbledhur gjithsej për 10 mujorin 97.1 miliardë lekë, ose 1.7 përqind më shumë se një vit më parë dhe -6.8 përqind më pak se parashikimi për vitin 2012.

Tatimi mbi vlerën e shtuar 10Mujori krahasuar me viti 2011

EMERTIMI	2011	2012
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Total (milion leke)	95,442	97,075
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Total (rritja vjetore ne %)	1.8	1.7
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Dogana (milion leke)	74,234	76,097
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Dogana (rritja vjetore ne %)		2.5
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Tatime (milion leke)	21,206	20,978
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Tatime (rritja vjetore ne %)		-1.1

Nga Administrata Doganore janë mbledhur 76 miliardë lekë TVSH mbi mallrat e importuar, duke realizuar planin e periudhës në masën 95.2 përqind. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 78.3 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 1.7 miliardë lekë më shumë ose 2.5 përqind më shumë. Për muajin tetor TVSH në doganë ka një realizim prej 46 milionë lekë ose 0.5 përqind më shumë se parashikimi mujor. Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara, çmimet në import dhe kursi i këmbimit). Nga statistikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, importet e periudhës janar tetor 2012 rezultojnë 453.6 miliardë lekë, me rënie vjetore prej 0.6 përqind. Me rënie vjetore janë importi i taksuar (-1.2 përqind), dhe importi nën regjimin e përpunimit aktiv (-2.15 përqind). Importi i pataksuar ka një rritje të lehtë vjetore prej 1.76 përqind.

Nga administrata tatimore për periudhën Janar – Tetor janë mbledhur 21 miliardë lekë TVSH nga 24.2 miliardë lekë të planifikuara, që do të thotë -13.3 përqind më pak se parashikimi dhe -1.1 përqind më pak se një vit më parë. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 21.7 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja.

Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 10 mujore nga tatimet dhe doganat ka arritur shifrën 6.76 miliard lekë me një rritje vjetore prej 25.9 përqind, sikurse pasqyrohet në tabelë.

Milionë lekë	2011	2012	Në % ndaj 2011
TVSH e arkëtuar (bruto)	100,812	103,840	3
TVSH neto	95,440	97,075	1.7
Rimbursimi faktik i paguar	5,372	6,765	25.9

Në strukturën e të ardhurave tatimore që mbledhin tatimet, vihet re renie e peshës specifike të TVSH-së ndaj totalit, nga 22 përqind në 10 mujorin 2011 në 21.7 përqind për 10 mujorin 2012. Sikurse e shikojmë dhe në tabelën e mëposhtme që pasqyron TVSH-në e mbledhur sipas sektoreve, rritjen e vetme e ka pësuar sektori i Shërbimeve me 33.7%. Sektoret që kanë pësuar një rënie të ndjeshme janë sektori i Prodhimit me -24.2%, sektori i Ndertimit me -11.1%, sektori i Transportit me -29.6% dhe sektori i Tregtisë me -4.4%.

TVSH-ja sipas sektoreve kryesorë të ekonomisë

Emërtimi	10 mujor 2011	10 mujor 2012	Ndryshimi	Subjekte pagues 2011	Subjekte pagues 2012	Ndryshimi
	<i>(mln leke)</i>	<i>(mln leke)</i>	<i>ne %</i>	<i>numër</i>	<i>numër</i>	<i>ne %</i>
Prodhim	6,556	4,972	-24.2%	1,338	1,439	7.5%
Ndërtim	4,424	3,931	-11.1%	1,840	1,763	-4.2%
Transport	372	262	-29.6%	314	348	10.8%
Tregti	3,634	3,475	-4.4%	3,792	4,096	8.0%
Shërbime	6,234	8,337	33.7%	4,678	5,580	19.3%

Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar – Tetor arritën në rreth 30.7 miliardë lekë; ose -11.5 % më pak se parashikimi sipas planit; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011, të ardhurat nga kjo taksë kanë rënë në masën -6.1 përqind.

Të ardhurat nga akciza (10 Mujori në vite)

	2010	2011	2012
Akciza gjithsej (mln lekë)	31,885	32,648	30,663
Ndryshimi vjetor (%)	11.7	2.4	-6.1
Dogane (mld lekë)	20,112	19,108	18,870
Tatime (mld lekë)	11,773	13,540	11,792

Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën pasqyrohet në tabelen që vijon:

Të dhënat e zhdoganimeve të mallrave të forta 10 Mujori në vite

	2009	2010	2011	2012
Karburantet (ton)	364,607	396,314	348,304	355,014
Ndryshimi ne %	4.07%	8.70%	-12.11%	1.93%
Birre (000 litra)	31,705	30,281	27,446	26,335
Ndryshimi ne %	8.18%	-4.49%	-9.36%	-4.05%
Cigare (ton)	3,728	3,499	2,606	2,933
Ndryshimi ne %	8.53%	-6.14%	-25.52%	12.53%
Kafe (ton)	5,962	4,981	5,448	6,074
Ndryshimi ne %	13.76%	-16.45%	9.37%	11.49%

Të ardhurat nga akciza që mbledhin Doganat kanë një rënie prej -1.2 përqind kundrejt një viti më parë dhe -11.6 përqind më pak se parashikimi për periudhën Janar-Tetor. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe kafes, si dhe të mallrave të tjerë që taksohen me anë të pullës së akcizës (sic janë mallrat që i janë shtuar listës së mallrave të akcizës, ambalazhet, llampat, baterite etj.). Të ardhurat e mbledhura nga importi i karburanteve kanë një rritje të lehtë në 10 mujorin 2012 kundrejt 2011. Mendojmë se pjesërisht kjo reflekton reagimin e subjekteve importuese ndaj rritjes së taksimit të karburanteve që nga 1 janari 2012, me rritjen e

taksës së qarkullimit në 7 lekë për litër, cka ka bërë që kompanitë të avancojnë importet në muajt e fundit të 2011.

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 11.8 miliardë lekë, me rënie vjetore -12.9 përqind dhe realizim të planit në masën 88.7 përqind. Tatimet mbledhën akcizën e të gjitha produkteve që duhet të pajisen me pulle akcize, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd. Por mbas I tetorit 2012 kjo mbledhet nga administrata doganore. Ka një rënie të ndjeshme të akcizës së paguar mbi karburantin e prodhuar në vend prej 67%, ndërsa është rritur akciza e paguar mbi pijet alkoolike që tregtohen me pullë, duke qënë se me fillimin e zbatimit të projektit koncesionar birra është futur në skemën e pajisjes me pullë, si në import ashtu dhe prodhimi vendas. Shifra e akcizës së mbledhur në import për pijet alkoolike i referohet importit të birrës për dy muajt e parë të vitit, para nisjes së zbatimit të projektit të pullave.

Lidhur me nivelet e akcizës, në gusht të 2011 hynë në fuqi disa ndryshime: akciza e birrës, u ndryshua në strukture dhe u reduktua ndjeshëm; u rrit niveli i akcizës për artikujt që përfshihen në kodet tarifore nga 27101951 deri 27101969, të seksionit V “Nënproduktet e naftës”, me emërtimin “Vajra të rënda si lëndë djegëse (solar, mazut, lëndë djegëse), nga 20 lekë për kg që është aktualisht në 37 lekë për kg; u rrit akciza e produktit “koks naftë” nga 1 lek për kg në 2 lek për kg. ssssss

Në aspektin e administrimit të akcizës për mallrat që pajisen me pullë, ka filluar të zbatohet projekti koncesionar për prodhimin dhe kontrollin e pullave fiskale (që nga muaji mars 2012). Përveç risive të tjera, mënyra e re e administrimit parashikon vendosjen e pullës së akcizës edhe mbi produktin birrë (kod sigurie në rastin e birrave të prodhuara në vend nga linjat e automatizuara të prodhimit). Fillimi i zbatimit të projektit mund të ketë patur ndikim të lehtë negativ në të ardhurat e mbledhura për këtë periudhë për shkak të ndryshimeve që ka sjellë për operatorët, deri sa procesi të konsolidohet. Në muajt e ardhshëm, në bazë të të dhënave të marra nga sistemi elektronik i administrimit të pullave, do të analizojmë ecurinë e të ardhurave nga produktet e vecanta dhe krahasimin me vitin e kaluar.

TAKSIMI DIREKT

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 22.6 miliardë lekë për periudhën janar-tetor, me rënie prej -0.4 përqind në krahasim me 10 mujorin e një viti më parë dhe me realizim të planit për vitin 2012 në masën 93.7 përqind. Sipas burimit të të ardhurave situata pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Tatimi mbi të ardhurat personale sipas komponenteve

Të ardhura, milionë lekë	10mujor 2011	10mujor 2012	Ndryshimi %
Tatimi mbi të ardhurat personale gjithsej	22,672	22,587	-0.4%
Paga sektori publik	7,292	7,375	1.1%
Paga sektori jo publik	7,213	7,725	5.6%
Interesa	2,763	2,968	7.4%
Dividendë	1,288	1,222	-5.2%
Shitje pasuri e paluajtshme	1,146	219	-80.9%
Te tjera	2,970	3,078	0.04%

Pozitive është ecuria e tatimit mbi pagat në sektorin privat edhe pas shfuqizimit të pagave referuese në qershor të vitit 2012, me rritje të të ardhurave prej 5.6%. Gjithashtu të ardhurat nga interesat mbi depozitat dhe investimi në obligacione kanë pësuar një rritje prej 7.4%. Në rënie janë të ardhurat nga dividendet (që lidhet dhe me ecurine e dobët të treguesit të tatim fitimit gjatë këtij viti), por kontributin më të madh në ecurine negative të TAP e ka patur tatimi mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme, që shpjegohet me procesin e legalizimit të pasurive të paluajtshme nga individët, proces i cili filloi më maj të vitit 2011 dhe u mbyll në 31 Gusht 2012.

Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 10 mujorin 2012 arritën në rreth 13.9 miliardë lekë nga 16.6 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rënie të ndjeshme prej -16.1 përqind, dhe -23.5 % më pak se plani i periudhës Janar-Tetor 2012. Në rezultatin e të ardhurave për tatim fitimin për periudhën janar-tetor këtë vit ka ndikuar ulja e derdhjes së tatim fitimit nga ndërmarrjet shtetërore me -60.3% krahasuar me një vit më parë ose 1.2 miliardë lekë më pak (kryesisht KESH sha). Përsa i përket sektorit privat, të ardhurat nga tatim fitimi janë ulur me -9.7% mbi baza vjetore. Të gjithë sektorët e ekonomisë kanë pësuar rënie për periudhën 10 mujore, duke e krahasuar me një vit më parë. Rënie më të madhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë e ka shënuar sektori i prodhimit me -26.2% i pasuar nga sektori i ndërtimit me -20.7%, sektori i transportit me -14.1%, sektori i shërbimeve me -11.9% dhe sektori i Tregtisë me -6.7%. Të dhënat pasqyrohen në Tabelën më poshtë.

Tatim Fitimi sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë

Emërtimi	10mujor 2011	10mujor 2012	Ndryshimi	Subjekte pagues 2011	Subjekte pagues 2012	Ndryshimi
	<i>(mln leke)</i>	<i>(mln leke)</i>	<i>ne %</i>	<i>numër</i>	<i>numër</i>	<i>ne %</i>
Prodhim	4,588	3,388	-26.2%	1,827	1,819	-0.4%
Ndërtim	2,445	1,940	-20.7%	1,550	1,755	13.2%
Transport	328	282	-14.1%	444	467	5.2%
Tregti	3,404	3,178	-6.7%	4,893	5,115	4.5%
Shërbime	5,823	5,133	-11.9%	1,870	1,976	5.7%

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 2 miliardë lekë, me rënie vjetore prej -18.9 përqind dhe plani i periudhës është realizuar në masën 73.1 përqind. Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezultojnë 61,818 subjekte me xhiro vjetore nën 8 milione lekë, ose 903 subjekte më shume se e njëjta periudhë e një viti më parë. Pjesa dërrmuese e subjekteve të reja i përkasin sektorëve të tregtisë dhe shërbimeve, ndërsa sektori i transportit dhe prodhimit rezultojnë perkatesisht 86 dhe 48 subjekte më pak.

Taksimi i pasurisë

Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat dhe mbi tokën bujqësore. Për 10 mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 2.3 miliardë lekë nga 1,8 miliardë lekë të parashikuara dhe 39.8 përqind më të larta se një vit më parë. Rritja në të ardhurat e mbledhura reflekton procesin e legalizimit të pasurive të paluajtshme nga subjektet juridike, pra bëhet fjalë për një element "one off measure".

Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën janë 23.9 miliardë lekë nga 18.5 miliardë lekë të parashikuara për periudhën janar – tetor, me tejkalim të planit 28.8 përqind. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash kanë pësuar një rritje prej 45.3 përqind, kjo si pasojë e ndryshimeve tatimore të ndërmarra për këto grup taksash vitin e kaluar. Këtu theksojmë ecurinë pozitive të rentës minerare, taksës së karbonit, taksën e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin dhe taksën vjetore mbi automjetet, të detajuara si më poshtë:

- Nga taksa e qarkullimit mbi karburantet, që u vendos me ndryshimin e ligjit të taksave kombëtare në muajin gusht të 2011 janë mbledhur rreth 3.3 miliardë lekë për periudhën 10 mujore 2012;
- Nga taksa vjetore mbi automjetet (e cila gjithashtu u ndryshua në nivel dhe strukturë me të njëjtin ligj) janë mbledhur për periudhën rreth 4 miliardë lekë nga 1.9 miliardë të një viti më parë
- Nga taksa e karbonit janë mbledhur nga administrata tatimore rreth 2.8 miliardë lekë nga rreth 1.7 miliarde të një viti më parë, si pasojë e rritjes së nivelit të taksës në gusht të vitit të kaluar
- Nga renta minerare janë mbledhur nga administrata tatimore rreth 1.2 miliarde lekë nga 1.16 miliarde të mbledhura një vit më parë për janar-tetor, ose 4.6 përqind më shumë
- Tek zëri “Taksa Nacionale” kemi dhe pasqyrimin e të ardhurave nga procesi i legalizimit të pasurive të paluajtshme nga individët, në nivel rreth 1.44 miliardë lekë për periudhën janar-gusht.

Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar – tetor janë rreth 5 miliardë lekë, -9.1 përqind më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 625 milionë lekë, ose -11.1 përqind. Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, taksa mesatare doganore për periudhën ka qenë 1.39 përqind nga 1.57 përqind e një viti më parë.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar – tetor arritën në 9.6 miliardë lekë nga 12.6 miliardë lekë të planifikuara, ndërsa kundrejt 10 mujorit të vitit 2011 të ardhurat janë ulur me 513 milionë lekë (rreth -5.1 përqind më pak). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë të cilat përmenden më sipër) kanë mbledhur rreth 5.3 miliardë lekë nga 8 miliardë lekë të parashikuara, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar këto taksa kanë pësuar një rënie prej -11.7 përqind.

Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën janar – tetor 2012 arritën në 48.3 miliardë lekë, me një rritje prej 2.6 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe -2.4 përqind më pak se parashikimi për periudhën. Ky grup të ardhurash përbën rreth 19.2 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë me 0.11 pikë përqindje rritje duke e krahasuar me peshën e të njëjtës periudhë në vitin e kaluar. Nga totali i fondeve speciale, rreth 47.3 miliardë

lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 41.2 miliardë lekë, me rritje vjetore 1.5 përqind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 6 miliardë lekë, 16.8 përqind më shumë se 10 mujori i një viti më parë.

Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 10 mujore rezultojnë se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 1.63 përqind, ose rreth 6.8 mijë njësi, kundrejt mesatares 10 mujore të 2011 nga ku sektori i shërbimeve pati rritje me 6.5 %. Ndërsa sektorët e tjerë patën ulje dhe përkatesisht sektori i prodhimit -2.15%, sektori i ndërtimit -5.7%, sektori i tregtisë -5.25% dhe sektori i transportit -1.14% me pak se mesatarja e së njëjtës periudhë një vit më parë.

Numri mesatar i të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve

	10-mujor 2011	10-mujor 2012	Ndryshimi ne %
Ndërmarrjet Buxhetore	139,037	138,590	-0.32%
Ndërmarrjet Shtetërore	21,899	20,581	-6.02%
Subjektet Private T.V.SH.	181,548	188,237	3.68%
Subjektet Biznes I Vogël	76,778	78,701	2.50%
Total	419,261	426,109	1.63%

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – TETOR 2012

Vështrim i përgjithshëm


Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit tetor 2012, arritën në rreth 299.0 miliardë lekë, nga rreth 308.5 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 96.9 përqind të parashikimit të periudhës ose me një mosrealizim prej rreth 9.6 miliardë lekë.

Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar- tetor 2012 duhet mbajtur parasysh se në realizimin faktik të tyre, janë përfshirë edhe shpenzimet e kryera nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit.

- **Fondi rezerve i Këshillit të Ministrave**, i planifikuar për vitin 2012, në 2.0 miliardë lekë, deri në fund të muajit tetor, është ekzekutuar në rreth 1.1 miliardë lekë, nga të cilat rreth 62.1 milionë lekë për shpenzime personeli, rreth 793.8 milionë lekë për shpenzime të tjera korrente dhe rreth 251.1 milionë lekë për investime.
- **Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit**, i planifikuar në rreth 2.66 miliardë lekë, deri në fund të muajit tetor 2012, është përdorur në rreth 2.17 miliardë lekë, nga të cilat 2.0 miliardë lekë janë dhënë në formën e huasë KESH-it dhe 171.8 milionë lekë në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimet, tek njesitë e qeverisjes vendore.

Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 75.3 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 0.4 miliardë lekë më pak ose rreth 0.1 përqind më të ulta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute si dhe ritmi i rritjes së tyre gjatë periudhës janar- tetor, në disa vite, jepet në grafikun e mëposhtëm:


Shpenzimet e përgjithshme janar-tetor në vite



Shpenzimet Korrente

Shpenzimet korente në fund të muajit tetor 2012, kanë arritur në rreth 254.2 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 78.9 përqind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 7.6 miliardë lekë më të larta ose rreth 3.1 përqind më shumë.

Shpenzimet korente janar- tetor




Shpenzimet e Personelit

Brenda shpenzimeve korente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 22.2 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar- tetor 2012, rezultojnë pothuajse në nivelin e parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime në fund të muajit tetor janë realizuar në rreth 79.7 përqind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 1.4 miliardë lekë më të larta, ose rreth 2.6 përqind më shumë.

Shpenzimet për paga janë rreth 2.6 përqind më të larta se një vit më parë ose rreth 1.2 miliardë lekë më shumë se një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 212 milionë lekë më shumë ose rreth 2.8 përqind më të larta, se një vit më parë. Pagat janë rreth 1.3 përqind mbi nivelin e parashikimit të periudhës dhe kontributi për sigurimet shoqërore pothuajse në nivelin e parashikimit, duke qenë në të njëjtën kohë respektivisht shpenzimet për paga rreth 83.4 përqind e planifikimit vjetor dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore në rreth 81.6 përqind e këtij planifikimi.


Shpenzimet për pagat janar-tetor



Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 12.2 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar- tetor 2012, rezultojnë me një kursim kundrejt parashikimit të periudhës, prej rreth 3.7 miliardë lekë, rrjedhëj kjo e kursimit për rreth 2.6 miliardë lekë në interesat e brendëshme dhe rreth 1.1 miliardë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 62.6 përqind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 488 milionë lekë më të larta ose rreth 1.6 përqind më shume. Ecuria e shpenzimeve për interesa gjatë periudhës janar- tetor, në vite, jepet nga grafiku i mëposhtëm:


Shpenzimet për interesa janar- tetor



Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar- tetor 2012 arritën në rreth 27.7 miliardë lekë, duke qënë rreth 4.7 miliardë lekë mbi nivelet e parashikuara. Ketu duhen mbajtur parasysh edhe përdorimet nga fondi rezerve i Keshillit të Ministrave dhe nga kontigjenca, të evidentuara me sipër. Në të njëjtën kohë keto shpenzime rezultojnë në rreth 95.4 përqind të planit vjetor.


Shpenzimet O&M janar- tetor



Shpenzimet për Subvencione

Shpenzimet për subvencione në fund të muajit tetor 2012 arritën në rreth 1.7 miliardë lekë ose rreth 417 milionë lekë më shume se parashikimi. Këtu duhet marrë parasysh edhe fakti i përmendur më sipër se rreth 171.8 milionë lekë janë dhënë me vendime të Këshillit të Ministrave, në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore.

Shpenzimet per subvencione janar-tetor




Shpenzimet për Fonde Speciale

Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës janar- tetor 2012 rezultojnë rreth 1.4 miliardë lekë më pak apo rreth 1.4 përqind nën nivelin e parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 80.5 përqind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 82.1 përqind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore në rreth

80.7 përqind të këtij plani, ndersa shpenzimet per kompensimin e pronareve jane realizuat ne rreth 66.7 perqind te planit vjetor.

Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 3.7 miliardë lekë më të larta ose rreth 8.0 përqind më shumë, shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 1.4 miliardë lekë më të larta, ose rreth 6.2 përqind më shumë, ndërsa shpenzimet per kompensimin e pronareveishin rreth 305 milione leke me te ulta.


Shpenzimet per sigurimet sociale janar- tetor



Shpenzime të Pushtetit Lokal

Shpenzimet e pushtetit vendor zunë rreth 8.6 përqind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar- tetor 2012 ato kanë arritur në rreth 21.8 miliardë lekë, ose rreth 262 milione leke nen nivelin e planifikimit për këtë periudhë të vitit 2012. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur në rreth 73.9 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 1.0 miliardë lekë më të ulta ose rreth 4.5 përqind më pak. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit vendor për periudhen janar- tetor për disa vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.

Shpenzimet për pushtetin lokal janar- tetor




Pagesa e Papunësisë

Pagesa e papunësisë është realizuar në rreth 102.9 përqind të parashikimit të periudhës, duke qënë rreth 82.8 përqind e parashikimit vjetor si dhe rreth 121 milione leke me shume se në të njëjtën periudhë të një viti më parë ose 17.1 përqind me e larte.

Ndihma ekonomike gjatë periudhës janar- tetor 2012 rezulton rreth 870 milionë lekë më shume ose rreth 6.3 përqind mbi parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 86.8 përqind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë ndihma ekonomike rezulton rreth 1.3 miliardë leke me shume ose rreth 9.6 përqind me e larte.

Shpenzimet për mbrojtjen sociale janar- tetor




Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit tetor 2012 janë realizuar në rreth 64.0 përqind të planit vjetor. Këtu duhet të mbahet parasysh edhe fakti se rreth 251.1 milionë lekë janë dhënë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për investime. Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 79.5 përqind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 62.5 përqind të parashikimit vjetor.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brendëshme rezultojnë rreth 12.1 miliardë lekë më të ulta ose rreth 35.7 përqind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 5.2 miliardë lekë më të larta ose rreth 29.1 përqind më shume. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit tetor 2012 janë rreth 13.8 përqind më të ulta ose rreth 7.2 miliardë lekë më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Shpenzimet kapitale janar-tetor



Struktura e investimeve kapitale të realizuar gjatë periudhës janar- tetor 2012 është rreth 58.9 përqind nga financimi i brendshëm dhe rreth 51.1 përqind nga financimi i huaj.

